

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

MULTIMEDIA
(dual)

Niveli IV i KSHK
(2 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor TIK)

Kodi: T5-1-IV-24

(Hartuar në kuadër të zbatimit të sistemit dual, me mbështetjen e Projektit “Aftësi për Punë”, financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) dhe zbatuar nga Swisscontact)

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2024

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, 2 vjeçar, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit - TIK”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar).**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.
- III. Plan i mësimor për profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Multimedia”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithëshme të lëndëve profesionale dhe përshkruesit e moduleve profesionale të zbatuara në shkollë.**
- IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të zbatuar në biznes.**
- X. Programi orientues i provimeve përfundimtare të kualifikimit profesional “Multimedia – dual”, niveli IV i KSHK.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK, të drejtimit “Teknologji e informacionit dhe komunikimit -TIK”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Multimedia - duale”, niveli IV i KSHK, të drejtimit “TIK”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me instalimin, krijimin, përpunimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi multimedial”*.

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtijshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “TIK”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë iniciativë dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të bëjë vlerësime dhe vetvlerësime, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Multimedia -dual”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelet e mëparshme, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të bëjë përzgjedhjen e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për proceset që lidhen me veprimtarinë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi multimedial.
- Të përdorë aparatet e realizimit të fotografive.
- Të listojnë elementët e fotografive, (afër, larg, dritë, ngjyra, kontrast rezolucion etj.) dhe argumentojë rëndësinë e tyre.
- Të zbatojë teknikat e regjistrimit të audio/videove.
- Të përcaktojnë karakteristikat e mediave digjitale.
- Të përcaktojnë llojet e krijimeve digjitale për radio dhe TV (sigla, reklama, video ilustruese etj.).
- Të përzgjedhë elementët multimedialë të nevojshëm që do të përmbajë video (tekst, fotografi, ngjyrat, audio, video, animacion).
- Të përcaktojë llojin e audios, formatin sipas standardeve.
- Të përcaktojë llojin e videos, formatin sipas standardeve.
- Të përcaktojë saktë kohëzgjatjen e videos dhe audios.
- Të realizojë videon dhe audion nëpërmjet mjeteve të nevojshme.
- Të realizojë editimin e një video dhe një audio.
- Të realizojë përpunimin dhe modifikimin e fotografisë nëpërmjet softuereve të përzgjedhur.
- Të realizojë ruajtjen dhe eksportimin e produktit sipas formatit të kërkuar.
- Të përdorë platformat dhe programet në dizajnim grafik.
- Të përdorë teknikat e ndryshme për fotografimin, video dhe audio.

- Të përgatitë mjedisin për printim të materialeve multimediale.
- Të realizojë printimin e produktit multimedial sipas metodës së përzgjedhur.
- Të realizojë animacione digjitale 2D.
- Të krijojë animacione digjitale 3D.
- Të përshtasë produktin multimedial për publikim në medie të ndryshme.
- Të realizojë dizenjimin e materialeve të brandbook.
- Të komunikojë me etikë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin “Multimedia - duale”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Multimedia - duale”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me çertifikatën e teknikut/menaxherit në këtë profil profesional. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar apo vetëpunësuar në pozicionet e teknikut në multimedia si dhe pranë institucioneve e bizneseve të dimensioneve të ndryshme (në studio grafike, në kompanitë mediatike, në industrinë e printimit, në kompanitë e marketingut, në kompanitë e zhvillimit të websiteve dhe softuerëve, në studio produksioni etj.).

Ai/ajo edhe mund të vetëpunësohet në këtë veprimtari dhe pas një përvoje pune e trajnimeve të vazhdueshme, mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në veprimtarinë profesionale në fushëm e medias.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare si dhe të arsimit pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK (2 vjeçar).

Plani mësimor për profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimorë	Orët javorë/vjetorë	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	9/10 (324/ 360)	13/14 (416/ 448)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	2
7		Gjeografi	1	-
8		Biologji	-	2
9		Fizikë	-	1
10		Shkenca sociale	-	1
11		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	2

B.		Lëndët/Modulet profesionale të zbatuara në shkollë (Gjithësej)	6 (216)	6 (192)
1	L-17-157-24	Bazat e sipërmarrjes	36	32
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	32
3	M-26-2023-24	Realizimi dhe përpunimi i fotografisë	60	-
4	M-26-2024-24	Dizenjimi grafik dhe aplikimi në medie	120	-
5	M-26-2025-24	Realizimi dhe përpunimi video dhe audio	-	74
6	M-26-2026-24	Krijimi i animacioneve	-	54
C.	P-26-004-24	Praktika profesionale në biznes (Gjithësej)	24 (864)	20 (640)
		Gjithësej A+B+C	39/40 (1404/ 1440)	39/40 (1248/ 1280)
D.		Praktika profesionale verore në biznes (4 javë)	160	-

IV. Udhëzime për planin mësimor

Skeletkurrikula e kualifikimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët/modulet profesionale teorike/praktike të zbatuara në shkollë (programet e përgjithshme/përshtatjes të tyre janë pjesë e kësaj skeletkurrikule).
- Praktika profesionale në biznes (Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale në biznes është pjesë e kësaj skeletkurrikule).
- Praktika profesionale verore në biznes.

Në klasën 12:

Procesi mësimor realizohet për 36 javë mësimore (viti shkollor ka gjithsej 36 javë)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 40 orë mësimore (nga të cilat, 15/16 orë mësimore teorike dhe praktike në shkollë dhe 24 orë mësimore praktikë në biznes).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Rekomandohet që **modulet profesionale** (teorike/praktike) që zbatohen në shkollë të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

Praktika profesionale në biznes mund të kryhet e shpërndarë (36 javë x 3 ditë në javë x 8 orë mësimore 45 minutëshe) ose e grupuar (108 ditë, në ndarje javore/dyjavore/mujore).

Në biznes, 1 ditë pune = 6 orë pune = 8 orë mësimore 45 minutëshe.

Praktika profesionale verore në biznes (4 javore, pas përfundimit të periudhës mësimore në klasën 12) realizohet nën mbikqyrjen e instruktorit të biznesit, e paprogramuar dhe e orientuar te veprimtaritë reale të biznesit përkatës.

Vëllimi i përgjithshëm mësimor është si më poshtë:

Teoria (e përgjithshme dhe profesionale) dhe praktika profesionale në shkollë (38.5%):

36 javë x 15/16 orë mësimore/javë = 540/576 orë mësimore

Praktika profesionale në biznes (61.5%):

36 javë x 3 ditë/javë x 8 orë mësimore/ditë = 864 orë mësimore

Praktika profesionale verore në biznes:

4 javë x 5 ditë/javë x 8 orë mësimore/ditë = 160 orë mësimore

Në klasën 13:

Procesi mësimor realizohet për 32 javë mësimore (viti shkollor ka gjithsej 36 javë, 32 javë mësim dhe 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 40 orë mësimore (nga të cilat, 19/20 orë mësimore teorike dhe praktike në shkollë dhe 20 orë mësimore praktikë në biznes).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Rekomandohet që **modulet profesionale** që zbatohen në shkollë të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

Praktika profesionale në biznes mund të kryhet e shpërndarë (32 javë x 2 ditë në javë x 10 orë mësimore 45 minutëshe) ose e grupuar (64 ditë, në ndarje javore/dyjavore/mujore).

Në biznes, 1 ditë pune = 8 orë pune = 10 orë mësimore 45 minutëshe.

Vëllimi i përgjithshëm mësimor është si më poshtë:

Teoria (e përgjithshme dhe profesionale) dhe praktika profesionale në shkollë (48.7%):

32 javë x 19/20 orë mësimore/javë = 608/640 orë mësimore

Praktika profesionale në biznes (51.3%):

32 javë x 2 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 640 orë mësimore

Për kl.12 dhe 13, vëllimi i përgjithshëm i mësimorit në shkollë është **43.6%** dhe i praktikës profesionale në biznes është **56.4%**.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

a) Për realizimin e procesit mësimor në shkollë

Mësuesit e lëndëve/moduleve teorike/praktike profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbyshjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën profesionale*. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Multimedia - duale”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimorit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë saj*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Multimedia - duale”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

B. Për realizimin e praktikës profesionale në biznes.

Realizimin e praktikës profesionale në biznes duhet të krijojë mundësi për një zbatim të kompetencave në realitetin profesional të multimedias. Biznesi duhet të caktojë personat përgjegjës për mbështetjen e nxënësve në realizimin e programit. Shkolla duhet të informojë biznesin për numrin e nxënësve që do të kryejnë praktikën në këtë biznes, periudhën kohore, programin e praktikës dhe programin që kanë kryer më parë në shkollë.

Planifikimi i realizimit të praktikës në biznes duhet të bazohet në një proces analize fillestare duke marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, programi i përgjithshëm i praktikës në biznes, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e realizuar më parë në shkollë, objektivat konkretë që do të arrihen në biznes, mundësitë dhe kushtet e biznesit për realizimin e praktikës së nxënësve etj. Ky planifikim kryhet në bashkëpunim të ngushtë midis personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës me përfaqësues të biznesit.

Shkolla është e detyruar të mbikëqyrë dhe mbështesë realizimin e programit, bazuar në marrëveshjet paraprake, nëpërmjet instruktorit përgjegjës.

Plani i detajuar i realizimit të praktikës në biznes, raportet e ecurisë së praktikës, shkalla e përmbushjes së programit si dhe fletët e vlerësimit të nxënësve duhet të jenë pjesë e dokumentacionit për realizimin e praktikës në biznes.

Biznesi duhet të përfshijë, motivojë dhe mbikëqyrë nxënësit në të gjitha veprimtaritë e parashikuara në program. Dhënia e përgjegjësisë në vendin e punës, puna e mbikëqyrur dhe pavarur duhet të jenë pjesë e realizimit të programit.

Nxënësi duhet të dokumentojë në portofolin e tij të gjitha përvojat dhe rezultatet nga praktika profesionale në biznes, të përgatitë një raport dhe ta prezantojë në klasë, si pjesë e këtij portofoli.

Vlerësimi i nxënësit në biznes duhet të përfshijë vlerësimin e tij gjatë gjithë praktikës si dhe vlerësimin përfundimtar për çdo kompetencë profesionale dhe personale, që përmbahet në program. Pjesë e vlerësimit përfundimtar duhet të jetë edhe vlerësimi i portofolit të nxënësit, që shërben gjithashtu edhe për vetvlerësimin.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Multimedia - duale”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI)

b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithëshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e instalimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve kompjuterike.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Multimedia - dual”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me Certifikatën profesionale të nivelit IV të KSHK, si dhe me suplementin

përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale, moduleve profesionale dhe në praktikën profesionale në biznes, për çdo vit shkollor;

- rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithëshme të lëndëve profesionale dhe përshkruesit e moduleve profesionale të zbatuara në shkollë.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-24). Kl. 12 – 36 orë dhe Kl. 13 – 32 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 36 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	1 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	1 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	2 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	2 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	2 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	2 orë

Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	2 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	2 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	2 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	2 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	2 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	2 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	2 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	2 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	2 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	2 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	2 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	2 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	2 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	2 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	3 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	3 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	3 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	2 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve	3 orë

	njerëzore	
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	2 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	3 orë
Tema 9	Buxheti në biznes	2 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	3 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	2 orë
Tema 13	Siguracionet personale	2 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13-32 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetje	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	4 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	4 orë

3. Moduli “Realizimi dhe përpunimi i fotografisë”

Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit
Profili: Multimedia-dual
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REALIZIMI DHE PËRPUNIMI I FOTOGRAFI	M-26-2023-24
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko praktik që aftëson nxënësit për të kryer procese pune në realizimin dhe në përpunimin e fotografisë.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Teknologji e informacionit dhe komunikimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen procese pune të realizimit të fotografisë Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë kuptimin, historikun, llojet dhe rëndësinë e fotografisë; - të përshkruajë llojet dhe karakteristikat e fotografive (<i>portrete, peisazhe, objekte etj.</i>); - të listojë funksionet bazike të aparatit fotografik; - të dallojë aksesoret bazë (<i>lentet, blici, stativi, dritat, fotometri etj.</i>) për realizimin e fotografisë; - të listojë elementet e realizimit të fotografisë; - të përshkruajë teknikat e realizimit të fotografisë; - të dallojë llojet e fotografisë (<i>interior dhe eksterior</i>); - të listojë programet softuerike të duhura për realizimin dhe përpunimin e fotografisë (<i>Adobe Photoshop, Lightroom etj.</i>); - të realizojë fotografinë, (<i>portret, peisazh, objekt</i>) sipas parametrave të kërkuar; - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së proceseve të punë të realizimit të fotografisë; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës të realizimit të fotografisë; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje - Diskutim - Vëzhgim me listë kontrolli	
	RN 2 Nxënësi realizon përpunimin e fotografisë. Kriteret e vlerësimit:	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për realizimin dhe përpunimin e fotografisë;
- të kryejë kontrollin teknik të mjeteve të realizimit dhe përpunimit të fotografisë;
- të testojë parametrat e duhura për realizimin e fotografisë;
- të realizojë fotografinë në ambiente të brendshme (*interior*);
- të realizojë fotografinë në ambiente të jashtme (*eksterior*);
- të mirëmbajë mjetet e realizimit të fotografisë, sipas rregullave të përcaktuara;
- të përzgjedhë fotografitë sipas kriterëve të kërkuara;
- të përpunojë fotografinë sipas kriterëve të kërkuara;
- të eksportojë fotografinë sipas formatit dhe dimensionit të përcaktuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të realizimit dhe përpunimit të fotografisë;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së përpunimit të fotografisë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të fotografisë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e multimedias. Rekomandohet që ky modul mund të realizohet edhe në studio fotografike, agjenci marketingu, media të ndryshme etj..
 - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për realizimin dhe përpunimin e fotografive, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me realizimin dhe përpunimin e fotografisë.
 - Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për realizimin dhe përpunimin e fotografive të caktuara, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
 - Mësuesi duhet të nxitë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten gjatë realizimit dhe përpunimit të fotografisë.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
-

4. Moduli “Dizenjimi grafik dhe aplikimi në medie”

Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit
Profili: Multimedia- dual
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DIZENJIMI GRAFIK DHE APLIKIMI NË MEDIE	M-26-2024-24
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko - praktik që aftëson nxënësit, për të përshkruar bazat e dizenjimit grafik, për të zbatuar parimet dhe teknikat e dizenjimit grafik në programet e dhura, si dhe për të aplikuar grafika në medie përkatëse.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Teknologji e informacionit dhe komunikimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan bazat e dizenjimit grafik Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë historinë e evolimit të dizenjimit grafik; - të listojë elementet bazë të dizenjimit; - të përshkruajë strukturën (layout) e një ‘kompozimi grafik’; - të përshkruajë teorinë e ngjyrave; - të dallojë nuancat e ngjyrave dhe skemat e ngjyrave plotesuese; - të identifikojë ndryshimet midis ngjyrave RGB, CMYK për projekte dhe media specifike; - të përshkruajnë historinë e shkronjave dhe funksionet e tipografisë; - të përshkruajë ndryshimet midis klasifikimeve të fontit të tekstit, stileve dhe familjeve të fontit; - të përshkruajë parimet dhe përdorimin e elementeve bazë të dizajnit si: linja, forma, vëllimi, hapësira, vlera, tekstura, ngjyra, shkalla/ proporcioni, hierarkia, uniteti, kontrasti, përsëritja/ ndryshimi dhe ritmi; - të përshkruajë rëndësinë e hapësirës së bardhë ose boshe në krijimin e veprave grafike; - të listojë llojet e produkteve të medias së printuar (billboard, citylight, poster, broshura, revista katalog etj.); - Të listojë llojet e medias digjitale (faqe internet, mediat sociale, broshura, platformat video etj.);	

Instrumentet e vlerësimit:

- Shpejgim.
- Pyetje - përgjigje.
- Diskutim.

RN 2 Nxënësi zbaton parimet dhe teknikat e dizajnimit grafik në programet e duhura.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të njihet me softueret e dizajnit grafik (p.sh., *Adobe Photoshop, Illustrator, Adobe InDesign, Canva*);
- të përdorë opsionet dhe veçoritë thelbësore sipas programit të përcaktuar;
- të dallojë hapësirat e punës sipas programit të përcaktuar;
- të përcaktojë layout-in sipas programit të përcaktuar;
- të përdorë shtresat (*Layers*) sipas programit të përcaktuar;
- të zhvillojë grafika vektoriale dhe ilustrime;
- të përdorë mjetet e *Quick Selection, Quick Mask* ose *Pen Tool* dhe mjeteve të tjera;
- të zbatojë detyrat themelore të redaktimit të imazhit si prerja, ndryshimi i madhësisë, retushimi dhe korrigjimi i ngjyrave;
- të përdorë teknika të avancuara të redaktimit, siç janë mënyrat e përzierjes dhe filtrat;
- të krijojë dhe modifikojë imazhe digjitale duke përdorur shtresa, maska dhe mjete të tjera thelbësore në softuerin e projektimit;
- të zbatojnë teknikat softuerike për të eksportuar dhe optimizuar imazhet për ekran apo printim;
- të organizojë skedarët e dokumentave të dizajnit në mënyrë efektive për të përmirësuar rrjedhën e punës;
- të krijojë print teste dhe prototipe grafike (*mockups*) për të shfaqur më mirë konceptet e dizajnit;
- të testojë printimin për të kuptuar nevojat dhe kufizimet e tyre në lexueshmëri;
- të testojë rezolucionin dhe përshtatshmërinë e grafikave digjitale;
- të ruajë dhe eksportojë në formatin e duhur dizajnin sipas kërkesës dhe qëllimit të përdorimit të tij (*PSD, JPEG, EPS, GIF, PNG, RAW, PDF*, etj.);
- të zbatojë politikat e sigurisë në përdorimin e harduerë, softuerë dhe të dhënat sipas legjislacionit përkatës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të parimeve dhe teknikave të dizajnimit grafik në programet e duhura;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi aplikon grafika të krijuara në mediet përkatëse.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë mediat tradicionale dhe digjitale;
- Të theksojë rëndësinë e një audience të synuar;
- Të përshkruajë specifikimet e layout-it për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të krijojë layout-in e kërkuar për median e printuar;
- Të krijojë layout-in e kërkuar për median digjitale;
- Të përshkruajë specifikimet e tipografisë për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të krijojë layout-e me tipografitë e kërkuara për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të përshkruajë specifikimet e ngjyrave për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të krijojë layout-e me ngjyrat e kërkuara për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të përshkruajë specifikimet e dimensioneve për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të përshtasë layout-in kryesor sipas dimensioneve të kërkuara për aplikim në media të printuara dhe digjitale;
- Të specifikojë bazat e aplikimit të markës në hapësirën e medias përkatëse;
- Të vendosë markën në layout sipas përshkrimit të Brandbook (rregullat e markës);
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të dizajnit grafik dhe aplikimit në mediet përkatëse.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë aplikimit të grafikave të krijuara në mediet përkatëse;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dizajnit grafik dhe aplikimit të grafikave të krijuara në mediet përkatëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e multimedias.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për zbatimin e parimeve e dizajnit grafik, aplikimit të grafikave të krijuara në mediet përkatëse si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me dizajnimin grafik dhe aplikimin e grafikave të krijuara në mediet përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për zbatimin e parimeve e dizajnit grafik, aplikimit të grafikave të krijuara në mediet përkatëse si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me dizajnimin grafik dhe aplikimin e grafikave të krijuara në mediet përkatëse, sipas kriterëve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Mësuesi duhet të nxitë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten gjatë dizajnit grafik dhe zbatimit të grafikave të krijuara në mediet përkatëse.

	– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Laborator multimedial. - Lidhje në internet. - Programet e nevojshme për realizimin e dizajneve grafike (<i>Adobe Photoshop, Illustrator, Adobe InDesign, Canva</i> etj.). - Materiale për printim të dizajneve. - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.

5. Moduli “Realizimi dhe përpunimi video dhe audio”

Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit
Profili: Multimedia -dual
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REALIZIMI DHE PËRPUNIMI VIDEO DHE AUDIO	M-26-2025-24
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko - praktik që aftëson nxënësit për të realizuar dhe përpunuar një video dhe audio.	
Kohëzgjatja e modulit	74 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën 12 të profilit mësimor “Multimedia”, niv. IV i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përshkruan realizimin e një video dhe audio. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të listojë programet softuerike të duhura për realizimin dhe përpunimin e video-ve dhe audio-ve (<i>Premiere Pro, Final Cut, Avid Resolve, Audition Cubase, etj.</i>); - të përshkruajë llojet dhe rëndësinë e video-s dhe audio-s - Të listojë komponentet përbërës që përmban një video (filmimi, audio, efektet, titrat etj.); - Të përshkruajë pajisjet dhe teknologjinë e përdorur në prodhim; - të mbledhë të dhëna mbi objektivat e realizimit të videos - të përshkruajë programet dhe formatet e video-ve dhe audio-ve; - të përcaktojë hapat e punës për realizimin e e video-ve (editim, 2D, 3D) dhe audio-ve (muzika, narativi, efektet); - të përshkruajë metodikat e duhura për realizimin e video-ve dhe audio-ve; - të përshkruajë tendencat dhe inovacionet aktuale në prodhim; - të përzgjedhë elementët multimedial të nevojshëm që do të përmbajë video (tekst, fotografi, ngjyrat, audio, video, animacion); Instrumentet e vlerësimit: - Shpjegim. - Pyetje – përgjigje - Diskutim.

RN 2

Nxënësi krijon video dhe audio sipas kërkesave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për krijimin e videos dhe audios;
- të kryejë kontrollin e mjeteve, pajisjeve dhe aparateve për krijim e videos;
- të realizojë mbledhjen e të dhënave/materialeve mbi objektivat e Video-s;
- të përzgjedhë programet e nevojshme;
- të zbatojë komandat në program (*Tools panel and Options panel*);
- të realizojë prerjet e video-s në program, duke përdorur mjetet e duhura (tools te program);
- të realizojë shtimin e tekstit në një video;
- të realizojë importimin e elementeve grafik në një video;
- të realizojë lëvizjet (animacion në 2D, X,Y) e elementeve të importuar (foto, pamje grafike, tekst etj.) në një video;
- të realizojë vendosjen e video-efekteve, kalimin nga një imazh në një tjetër, animacionet etj.;
- të realizojë përpunimin e imazheve si korigjimi i ngjyrës, aplikimi i efekteve, aplikimi i filtrave special;
- të realizojë vendosjen e audios në video;
- të realizojë prerjet e Audio-së në program, duke përdorur mjetet e duhura (tools të programit);
- të realizojë vendosjet e efekteve në audio;
- të realizojë nivelimin e audios me efektet;
- të realizojë integrimin e elementëve të videos dhe audios në produktin final;
- të realizojë videon në formate dhe dimensione të ndryshme dhe ta eksportojë sipas formateve të kërkuara (mpeg, mp4, avi, h.264 etj.);
- të realizojë dhe eksportojë audion sipas formateve të kërkuara (mp3, wav etj.);
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës të realizimit dhe përpunimit të videos dhe audios;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë realizimit dhe përpunimit video dhe audio;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit dhe përpunimit video dhe audio;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e multimedias. – Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për realizimin dhe përpunimin video dhe audio, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me realizimin dhe përpunimin video dhe audio. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për realizimin dhe përpunimin video dhe audio, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. – Mësuesi duhet të nxitë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten gjatë realizimit dhe përpunimit video dhe audio. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Laborator i multimedias të performancës së lartë. - Lidhje në internet. - Programet e nevojshme për realizimin dhe përpunimin video dhe audio. - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.

6. Moduli “Krijimi i animacioneve

Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit
Profili: Multimedia
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	Krijimi i animacioneve	M-26-2026-24
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko - praktik që aftëson nxënësit për të realizuar përpunimin e audio-video në animacion 2D dhe për të krijuar animacione në 3D.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën 12 të profilit mësimor “Multimedia”, niv. IV i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi realizon përpunimin e audio-video në animacionin 2D. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë teknikën e ndërtimit Video; - të zbatojë teknikën e përzgjedhur për ndërtimin e video, animacioneve 2D; - të zbatojë komandat bazë të <i>Adobe Premiere dhe After Effects</i> (komandat në program për animin e karaktereve, tekstit, imazheve etj); - të zbatojë parimet e animacionit dhe llojet e <i>keyframes</i> dhe modifikimin e tyre; - të realizojë forma (<i>shape</i>) dhe animacionin e tyre me <i>key frame</i>; - të realizojë animacion teksti me efektet e përcaktuara (plugins) nga softueri; - të zbatojë teknikat e animimit të tekstit sipas skenarit të animacionit 2D; - të realizojë teknikat e animacionit në <i>layer</i>; - të konfigurojë <i>frame dhe frame rates</i> sipas skenarit të projektit të animimit; - të përdorë <i>maskë</i> për secilën <i>frame</i> të animacionit; - të dizenojë elementët që do të animohen sipas skenarit të paracaktuar; - të vendosë në program kohën e elementëve të animimit sipas specifikimeve në skenarin e animacionit; - të realizojë ndjekjen e lëvizjes (<i>tracking</i>); - të zbatojë teknikat e animimit të grafikave dhe imazheve sipas skenarit të animacionit 2D;	

-
- të integrojë tipet e audios (muzika, efektet e zërit, VO) në varësi të skenarit të animacionit 2D;
 - të përcaktojë llojin dhe formatin audios, sipas standardeve;
 - të përcaktojë llojin dhe formatin videos, sipas standardeve;
 - të krijojë miksim në audio me disa audio të tjera;
 - të përcaktojë kohën e audio-s;
 - të përcaktojë saktë kohëzgjatjen e video-s dhe audio-s;
 - të realizojë integrimin e elementëve të animacionit në produktin final;
 - të zbatojë politikat e sigurisë në përdorimin e harduerë, softuerë dhe të dhënat sipas legjislacionit përkatës;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përpunimit të audio-video në animacion 2D;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të audio-video në animacion 2D;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi krijon animacione 3D.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të listojë programet softuerike të duhura për animimin 3D;
- të paraqesë teknikat e hyrjes në 3D;
- të realizojë tekstin në 3D;
- të përcaktojë lëvizjet/animacion;
- të përcaktojë teksturat/ngjyrat;
- të menaxhojë softueret 3D për montimin e materialit pëfundimtar;
- të realizojë importimin dhe eksportimin në softuerët e tjerë për editim, për vendosjen e audio-s;
- të krijojë shenjë sigurie digjitale (*watermark*) mbi audion dhe videon e krijuar për të mbrojtur të drejtat e autorit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me krijimin e animacioneve;
- të zbatojë politikat e sigurisë në përdorimin e harduerë, softuerë dhe të dhënat sipas legjislacionit përkatës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit të animacioneve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë krijimit të animacioneve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e multimedias. – Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për krijimin dhe realizimin e animacioneve në 2D dhe 3D, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me krijimin e animacioneve. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për krijimin dhe përpunimin e animacioneve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. – Mësuesi duhet të nxitë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten në krijimin dhe përpunimin e animacioneve. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Laboratori i multimedias. - Lidhje në internet. - Programet e duhura për realizimin e materialeve të animuara 2D dhe 3D. - Materiale të shkruara apo udhëzues në mbështetje të trajtimit të modulit.

IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të zbatuar në biznes

Kodi: P-26-004-24

Klasa 12: 36 javë x 3 ditë/javë x 8 orë mësimore/ditë = 864 orë mësimore

Në klasën 12, praktika profesionale e nxënësve në biznes do të kryhet bazuar në programin e përgjithshëm, si më poshtë:

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale	Koha (ditë)
1	Në Studio fotografike	Realizimi i fotove në studio/terren	- Të vëzhgojë mjediset dhe mjetet e punës. - Të përgatisë mjetet punës. - Të kontrollojë aksesorët. - Të realizojë fotografimin në interior. - Të realizojë fotografimin në eksterior. - Të dorëzojë materialin e realizuar, nga aparati në kompjuterin e studios. - Të përzgjedhë fotot e duhura. - Të përpunojë fototografitë e zgjedhura.	20 ditë
2	Në Studio e Dizajn Grafik/Agjenci Dizajni	Përdorimi i Softuerve	- Të njihet me Agjencinë e dizajnit dhe nevojat e saj në dizajn. - Të prezantohet me principet e dizajnit në projektet aktuale të kompanisë. - Të konfigurojë opsionet dhe layout-in e sipas nevojave të projektit. - Të përdorë mjetet bazike të softuerëve, sipas kërkesave të projektit siç janë: selektimi, pen tool, format, tekstet dhe tipografitë. - Të kryejë procese të ndryshme pune në Agjencinë e dizajnit.	20 ditë
3	Në Studio e Dizajn Grafik/Agjenci Dizajni	Krijimi i një projekti të caktuar (poster, broshurë, Banner, kolazh, logo, etj.) dhe grafikave përkatëse	- Të mbledhë informacionin e duhur mbi kërkesën e projektit (brief) me instrumente të ndryshëm. - Të analizojë të dhënat e mbledhura në funksion të projektit. - Të redaktojë objektivat e projektit. - Të krijojë ndarjen e Audiencës së Synuar. - Të ideojë mënyrën e realizimit të një projekti. - Të përzgjedhë teknologjitë e duhura për realizimin e projektit. - Të paraqesë një prezantim të modelit paraprak. - Të organizojë dokumentat me projekt-skedarë. - Të kryejë dallimin e formateve të dokumentave sipas softuerit. - Të përdorë mjetet bazike të selektimi.	60 ditë

			• Të presë dhe të eliminojë pjesët e padëshiruara. • Të përshtasë dizajnin me dimensionet e kërkuara. • Të rregullojë dritën balancën e ngjyrave dhe kontrastin. • Të aplikojë konceptin e layer-ave. • Të aplikojë filtrat dhe efektet e softuerit. • Të përdorë mjetet e vizatimit në softuer (lapsi, peneli). • Të kryejë kombinimet e tipografisë. • Të eksportojë dhe të ruajë dokumentat. • të eksportojë dokumentat për print. • të eksportojë dokumentat për ekerane. • të krijojë forma grafike vektoriale. • të krijojë maska. • të krijojë bashkime figurash vektoriale, prerje ose mbivendosje.	
4	Në Studio e Dizajn Grafik/Agjenci Dizajni	Krijimi i Identiteteve të Markës	• Të kryejë një fazë kërkimore mbi markat ekzistuese në treg. • Të krijojë logo. • Të krijojë një moodboard frymëzues. • Të krijojë kombinime tipografike. • Të vizatojë forma me anë të pen tool ose bashkimit të formave (pathfinder). • Të aplikojë logon në elemente printi për zyra. • Të zhvillojë një Brandbook bazik për përdorimin e markës. • Të prezantojë logon te klienti. • Të aplikojë ndryshimet e kërkuara nga klienti.	8 ditë
5	Në Studio e Dizajn Grafik/Agjenci Dizajni	Zbatimi i politikave të sigurisë	• Të përdorë fjalëkalime të forta dhe të aktivizojë autentifikimin me 2-faktorë. • Të ruajë rregullisht punën. • Të ketë kujdes nga sulmet phishing. • Të përdorë metodat dhe shërbimet cloud të sigurta për ndarjen e dokumenteve. • Të enkriptojë dokumentet sensitive. • Të sigurojë aksesin në kompjuter personal me fjalëkalim.	Çdo ditë
TOTALI				108 ditë

Vendi i punës	Kompetencat personale	Veprimtaritë
Në të gjitha mjediset e Studios fotografike dhe agjencisë grafike	• Korrektësia • Përpikmëria • Komunikimi • Pozitiviteti • Puna në grup	Në të gjitha veprimtaritë

	• Zgjidhja e problemeve • Ruajtja e konfidencialitetit • Besueshmëria • Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve • Fleksibiliteti • Pavarësia • Gadishmëria për punë	
--	--	--

Klasa 13: 32 javë x 2 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 640 orë mësimore

Në klasën 13, praktika profesionale e nxënësve në biznes do të kryhet bazuar në programin e përgjithshëm, si më poshtë:

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale	Koha (ditë)
1	Në dhomën e montazhit	Montimi i videos dhe audios	• Të kryejë pastrimin/montimin e videos. • Të kryejë pastrimin/montimin e audios.	5 ditë
2	Në studio Transmetimi	Asistimi në studiot e transmetimit	• Të zbatojë kërkesat e drejtorit të fotografisë për pozicionimin e kamerave. • Të kryejë rregullimin e mikrofonave sipas kërkesës të teknikut të audios. • Të zbatojë kërkesat e regjisorit.	5 ditë
3	Në postproduksion	Montimi i promove jingles	• Të kryejë montim të promove/ reklamave/ reportazheve/ etyd etj. • Të kryejë miksim të audios (jingles për siglat grafike, miksim për promot etj). • Të kryejë animacione 2D dhe 3D.	39 ditë
4	Në postproduksion audio	Miksimi i Audios	• Të kryejë miksim për radio Spote. • Të kryejë regjistrim të Audio në studio. • Të kryejë prodhim miksim të jinglave për Radio Spote.	5 ditë
5	Në studio transmatimi audio	Asistimi në pultin e transmetimit	• Të kryejë rregullimin e mikrofonave. • Të kontrollojë sinjalin e mikrofonave të prezantuesve të emisioneve në pultin e audios. • Të kontrollojë sinjalin e daljes së audios nga pulti i miksimit. • Të asistojë në emisionet e drejtpërdrejta. • Të kryejë kërkesat e teknikut të audios.	10 ditë
TOTALI				64 ditë

Vendi i punës	Kompetencat personale	Veprimtaritë
Në të gjitha mjediset ku zhvillohet dhe prodhohet Video dhe Audio	• Korrektësia • Përpikmëria • Komunikimi • Pozitiviteti • Puna në grup • Zgjidhja e problemeve • Ruajtja e konfidencialitetit • Besueshmëria • Menaxhimi dhe zgjidhja e problemeve • Fleksibiliteti • Pavarësia • Gadishmëria për punë	Në të gjitha veprimtaritë

X. Programi orientues i provimit përfundimtar të kualifikimit profesional “Multimedia – dual”, niveli IV i KSHK.

Përmbajtja e programit të Provimit Përfundimtar të Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues i provimit përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Multimedia - duale**”, **Niveli IV i KSHK** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	- të përgatitë vendin e punës për realizimin e fotografisë; - të testojë parametrat e duhura për realizimin e fotografisë; - të realizojë fotografinë në ambjente të brendshme; - të përzgjedhë fotografitë sipas kriterëve të kërkuara; - të eksportojë fotografinë sipas formatit dhe dimensionit të përcaktuar;	Detyra 1: Veprime në realizimin e nje fotografie ne laboratorin e multimedias.	25
2	- të mbledhë informacionin e duhur mbi produktin që do realizojë; - të konfigurujë opsionet dhe layout-in e sipas nevojave të produktit; - të përdorë në programin e zgjedhur mjetet e quick selection, quick mask ose pen tool dhe mjeteve të tjera;	Detyra 2: Veprime në dizenjimin grafik	25

	- të zbatojë detyrat themelore të redaktimit të imazhit si prerja, ndryshimi i madhësisë, korrigjimi i ngjyrave dhe kontrasti; - të kryejë kombinimet e tipografisë. - të eksportojë dhe të ruajë dokumentin.		
3	- të mbledh të dhënat mbi realizimin e videos; - të përzgjedhë programin e duhur; - të realizojë prerjet e video-s në program, duke përdorur mjetet e duhura (tools te program); - të realizojë shtimin e tekstit në video; - të realizojë importimin e elementeve grafik në video; - të realizojë vendosjen e audios në video; - të realizojë prerjet e Audio-së në program, duke përdorur mjetet e duhura (tools te programit); - të realizojë videon dhe ta eksportojë sipas formateve të kërkuara (mpeg, mp4, avi etj.);	Detyra 3: Veprime në fushën e realizimit të audios dhe videos.	25
4	- të zbatojë teknikën e përzgjedhur për ndërtimin e animacioneve; - të realizojë forma (shape) dhe animacionin e tyre me key frame; - të realizojë animacion teksti me efektet e përcaktuara nga softueri; - të konfigurojë frame dhe frame rates sipas skenarit të projektit të animimit; - të vendosë në program kohën e elementëve të animimit sipas specifikimeve në skenarin e animacionit; - të integrojë tipet e audios (muzika, efektet e zërit, VO) në varësi të skenarit të animacionit;	Detyra 4: Veprime në fushën e animacionit.	25
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “**detyra pune**” (në tabelë tregohen pesë detyrat kryesore të punës). Ai do të realizohet në laboratorët e

praktikave pranë shkollave profesionale për të gjitha ato procese që garantohen plotësisht në ambientet e bazës praktike. Për proceset që nuk garantohen në laboratorin e praktikave të shkollës, ato do të kryhen në ndërmarrje apo biznese, që plotësojnë kushtet për realizimin e tyre. Në rast të kundërt, rekomandohen si zgjidhje e vetme përfundimtare programet e virtualizimit dhe simulimit.

- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tre) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është **e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme** që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t'i kushtohet vëmendje **“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit”** gjatë gjithë kryerjes së detyrës për çdo nxënës.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve të punës etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve të punës, pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e këtyre detyrave.
- Nxënësit duhet t'i realizojë të gjitha detyrat.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për detyrën përfundimtare, si dhe mund të hartohet një grafik për përcaktimin e kohës së realizimit të secilës detyrë.
- Komisioni i provimit për secilën detyrë parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Detyrat e përcaktuara nga komisioni, paraqiten me anë të fletëve të punës (tezave të provimit), të cilat do të përzgjidhen nga nxënësit në mënyrë të rastësishme (duhet të hartohen disa variante për secilën detyrë).
- Nxënësit do të vlerësohen me anë të “listës së kontrollit”, me anë të së cilës verifikohen arritjet e tyre kundrejt “kriterëve të vlerësimit”.
- Fletët e punës (tezat e provimit), udhëzuesi dhe grafiku i kohës të bashkangjitura janë të detyrueshme t'i jepet çdo nxënësi. Gjithashtu një kopje bashkë me listën e vlerësimit mbahet

nga komisioni. Në fund bëhet lidhja e fletës së punës së nxënësit me listën e kontrollit për arsye dokumentimi.

Udhëzime për realizimin e detyrës 1, “Veprime në realizimin e nje fotografie ne laboratorin e multimedias.” Për realizimin e kësaj detyre, mësuesi harton paraprakisht disa variante tezash me detyra për realizimin e fotografisë në laboratorin e multimedias. Nxënësi pasi merr tezën në të cilën ka të specifikuar detyrën që duhet të kryej, fillon punën dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që ai kryen. Ndër detyrat, që nxënësi duhet të kryej janë:

- ✓ të përgatitë vendin e punës për realizimin e fotografisë;
- ✓ të testojë parametrat e dhura të mjeteve dhe materialeve që do përdorë për realizimin e fotografisë me mjetet e dhura;
- ✓ të realizojë fotografinë në ambiente të brendshme;
- ✓ të përzgjedhë fotografitë e realizuara sipas kriterëve të kërkuara;
- ✓ të eksportojë fotografinë sipas formatit dhe dimensionit të përcaktuar;

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit që lidhen me veprimet në fushën e përpunimit të imazhit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe. Nxënësi në këtë detyrë vlerësohet me listë kontrolli.

Udhëzime për realizimin e detyrës 2, “Veprime në fushën e dizajnit grafik”.

Paraprakisht , mësuesi hatron disa variante tezash me detyra për modifikimin dhe ruajtjen e imazheve në programin softwerik të përcaktuar si Adobe Photoshop. Nxënësi pasi merr tezën në të cilën ka të specifikuar detyrën që duhet të kryej, fillon punën dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që ai kryen.

Ndër detyrat, që nxënësi duhet të kryej janë:

- ✓ të mbledhë informacionin e duhur mbi produktin që do realizojë;
- ✓ të konfigurojë opsionet dhe layout-in e sipas nevojave të produktit në program;
- ✓ të përdorë në softuer mjetet e quick selection, quick mask, pen tool dhe mjeteve të tjera për modifikimin e elementeve grafike të përdorura;
- ✓ të zbatojë detyrat themelore të redaktimit të imazhit si prerja, ndryshimi i madhësisë, korrigjimi i ngjyrave dhe kontrastit;
- ✓ të kryejë kombinimet e tipografisë në tekstin që do përfshijë në produktin final;
- ✓ të eksportojë dhe të ruaj dokumentin.

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit që lidhen me veprimet në fushën e përpunimit të imazhit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe. Nxënësi në këtë detyrë vlerësohet me listë kontrolli.

Udhëzime për realizimin e detyrës 3, “Veprime në fushën e realizimit të audios dhe videos.”

Për realizimin e kësaj detyre, mësuesi harton paraprakisht disa variante tezash me detyra për përpunimin . Nxënësi pasi merr tezen në të cilën ka të specifikuar detyrën që duhet të kryej, fillon punën dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që ai kryen.

Ndër detyrat, që nxënësi duhet të kryej janë:

- ✓ të mbledh të dhënat mbi realizimin e Video-s;
- ✓ të përzgjedhë programin e duhur Adobe Premier;
- ✓ të realizojë prerjet e video-s në program, duke përdorur mjetet e dhura (tools te program);

- ✓ të realizojë shtimin e tekstit në video;
- ✓ të realizojë importimin e elementeve grafik në video;
- ✓ të realizojë vendosjen e audios në video;
- ✓ të realizojë prerjet e Audio-së në program, duke përdorur mjetet e duhura (tools te programit);
- ✓ të realizojë videon dhe ta eksportoje sipas formateve të kërkuara (mpeg, mp4, avi etj.);

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit që lidhen me veprimet në fushën e përpunimit të imazhit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe. Nxënësi në këtë detyrë vlerësohet me listë kontrolli.

Udhëzime për realizimin e detyrës 4, “Veprime në fushën e animacionit 2D”.

Për realizimin e kësaj detyre, mësuesi harton paraprakisht disa variante tezash me detyra për animimin 2D. Nxënësi pasi merr tezen në të cilën ka të specifikuar detyrën që duhet të kryej, fillon punën dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që ai kryen. Ndër detyrat, që nxënësi duhet të kryej janë:

- ✓ të zbatojë teknikën e përzgjedhur për ndërtimin e animacioneve 2D;
- ✓ të zbatojë komandat bazë të Adobe premier ose After Effects;
- ✓ të realizojë forma (shape) dhe animacionin e tyre me key frame;
- ✓ të realizojë animacion teksti me efektet e përcaktuara nga softueri;
- ✓ të konfigurojë frame dhe frame rates sipas skenarit të projektit të animimit;
- ✓ të vendosë në program kohën e elementëve të animimit sipas specifikimeve në skenarin e animacionit;
- ✓ të integrojë tipet e audios (muzika, efektet e zërit, VO) në varësi të skenarit të animacionit 2D;
- ✓ të përcaktojë saktë kohëzgjatjen e video-s dhe audio-s;

Komisioni i provimit paraprakisht duhet të përgatisë instrumentin e vlerësimit, me përshkrime të qarta të nivelit të përmbushjes, kriteret e vlerësimit që lidhen me veprimet në fushën e përpunimit të imazhit. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe. Nxënësi në këtë detyrë vlerësohet me listë kontrolli.